

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës duke u bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Witted Megacorp Oyj, me seli të regjistruar në Finlandë, 00530 Helsinki, Kaikukatu 4C, dorëzuar përmes avokates Ljupka Noveska Andonova nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 30.09.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Witted Megacorp Oyj, me seli të regjistruar në Finlandë, 00530 Helsinki, Kaikukatu 4C, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi Software Sauna sh.p.k. (Software Sauna d.o.o.), me seli të regjistruar në rrugën Stara Knezhija 20, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 03.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga ana e Witted Megacorp Oyj me seli të regjistruar në Finlandë, 00530 Helsinki, Kaikukatu 4C, me të cilin Witted Megacorp Oyj do të fitojë kontroll mbi Software Sauna sh.p.k., me seli të regjistruar në rrugën Stara Knezhija 20, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, dhe shtojcave të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Witted Megacorp Oyj është një shoqëri softuerike finlandeze e themeluar në vitin 2016 e cila ofron konsulencë për zhvillimin e softuerit dhe realizimin e projekteve, si dhe konsulencë për

rritje dhe shërbime rekrutimi për të mbështetur klientët në lidhje me zhvillimin e tyre të softuerit.

Witted Megacorp Oyj nuk ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024.

Software Sauna sh.p.k. është një shoqëri softuerike kroate e themeluar në vitin 2018, e cila u ofron klientëve të saj shërbime për zhvillimin e softuerit dhe të dhënave dhe shërbime për zhvillimin e inteligjencës artificiale.

Software Sauna sh.p.k. specializohet në ndërtimin e aplikacioneve ueb që përpunojnë njëkohësisht një numër të madh përdoruesish (high-traffic web applications) dhe specializohet në shkallëzimin e infrastrukturave të shpërndara (scaling distributed infrastructures), për të cilat shpesh nevojiten burime shtesë për t'u siguruar përmes outsourcing.

Ekspertiza e Software Sauna sh.p.k. konsiston në ndihmën ndaj klientëve kyç në krijimin, shkallëzimin dhe menaxhimin efektiv të ekipeve efikase që punojnë në distancë.

Software Sauna sh.p.k. ka prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së saj në pronësi të plotë:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime SOFTUER SAUNA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën Bul. Koço Racin nr. 8-Kulla/B15 Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare të regjistruar 62.100 – Programim kompjuterik.

SOFTUER SAUNA SHPKNJP Shkup ka vetëm klientë të huaj dhe nuk ka, dhe nuk planifikon të ketë ndonjë shitje biznesi në Maqedoninë e Veriut. Tregu kryesor i synuar i Softuer Sauna SHPKNJP Shkup është Finlanda dhe vendet e tjera skandinave.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ